**VENDIM**
**Nr. 611, datë 29.7.2020**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet kundërvlefta në lekë e shumës prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, në zërin: "shpenzime korrente", të programit 01110 "Planifikim, menaxhim, administrim", për pagesën e kontributit financiar të vendit tonë në Fondin e Mirëbesimit të NATO-s.
2. Efekti financiar i kundërvleftës në lekë, të shumës prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**